



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE  
RITHIRRJE PËR APLIKIM PROJEKTESH II PËR VITIN 2026

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në zbatim të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shpall këtë Rithirrje për Aplikim Projektesh II për vitin 2026, për institucione dhe organizata, të cilat punojnë dhe kontribuojnë në fushën e medias.

Subjektet e interesuara (më poshtë subjekti aplikues), ftohen që brenda **datës 17.07.2026, ora 12:00** të paraqesin dorazi/postë, në zyrën e protokollit të AMA-s, të gjithë dokumentacionin e propozimit për projektet në drejtimin e mëposhtëm :

### 1. Drejtimi: "Inkubatori i Edukimit Mediatik dhe Aftësive Multimediale"

Inkubatori i edukimit mediatik synon ngritjen dhe zhvillimin e një hapësire formuese dhe praktike, për të zhvilluar kapacitete, aftësi dhe modele pune në fushën e edukimit mediatik dhe multimedias për të rinjtë, përmes një qasjeje të integruar kërkimore dhe aplikative multidisiplinare. Në fokus të projektit është rritja e nivelit të edukimit mediatik dhe promovimi i standardeve profesionale dhe etike të medias si edhe reflektimi kritik mbi rolin e medias në shoqëri. Inkubatori do të nxisë ndërgjegjësimin e të rinjve nga fusha të ndryshme si gazetaria, dizajni grafik e multimedia, teknologjia e informacionit dhe marrëdhëniet publike e komunikimi, që të përfshihen në mënyrë aktive në realizimin e përmbytjeve mediatike, në përputhje me parimet dhe vlerat e gazetarisë së përgjegjshme dhe në shërbim të interesit publik sa i përket transparencës, besueshmërisë dhe etikës profesionale. Aktivitetet formuese dhe praktike do të organizohen në bashkëpunim me institucione arsimore, grupet e interesit dhe aktorë të medias e shoqërisë civile, duke ofruar trajnim, mentorim dhe ekspertizë e analizë kritike dhe duke shërbyer njëkohësisht si hapësira praktike për zhvillimin e aftësive mediatike, shkëmbimin e përvojave dhe diskutimin e çështjeve që lidhen me dezinformimin, cilësinë e informacionit dhe rolin e medias në shoqëri.

*Produktet që duhet të realizojnë subjektet aplikuese:*

- Një analizë mbi edukimin mediatik dhe multimedial, duke shqyrtuar mënyrat për të balancuar lirinë e fjalës me mbrojtjen e privatësisë në prodhimin e përmbytjeve mediatike nga të rinjtë.
- Aktivitete/ tryeza pune, në të paktën 6 qytete të vendit, ku do të parashtrihen gjetjet e këtij studimi analitik dhe do të diskutohen ide dhe pikëpamje që lidhen me të.
- Botimi me ISBN, ku do të përfshihet studimi i thelluar dhe dinamika e takimeve në qytete.

Fondi në dispozicion nga AMA për propozime në këtë drejtim është deri në masën 1,000,000 lekë.

### MËNYRA E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

1. Kërkesa për projekt-propozimin dërgohet në rrugë postare, ose dorazi pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në pikën 3.
2. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqëruar duhet të jenë në gjuhën shqipe.
3. Dokumentacioni i kërkuar për aplikim është:
  - a) Kërkesë për miratim të projekti-propozimit;
  - b) Formatin e aplikimit sipas modelit në **aneksin 1**;

- c) Jetëshkrimin profesional të grupit të punës që do të zhvillojë projektin;
  - d) Fotokopje të dokumentit të identifikimit të personit/personave që do të zhvillojë/zhvillojnë projektin;
  - e) Ekstraktin e Gjykatës për regjistrimin e subjektit në Republikën e Shqipërisë (i cili merret në Zyrën e Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë) - original ose kopje e noterizuar, lëshuar brenda 3-mujorit të fundit nga dita e aplikimit.
  - f) Dokumentin e regjistrimit në organin tatimor (NIPT)/Ekstrakt Historik QKB si dhe vërtetim që organizata është me status aktiv në momentin e aplikimit.
  - g) Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore i personave që do të zbatojnë projektin;
  - h) Informacion mbi financimin e projektit; (projekt-propozimi të jetë i shoqëruar me projektbuxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike dhe **aneksin 1**)
  - i) Në planin buxhetor të projekt-propozimit, vetë subjekti aplikues, detyrimisht duhet të ketë të pasqyruar një angazhim vetë financues jo më pak se 25% të vlerës totale të buxhetit.
  - j) Vërtetim që nuk ka detyrime të pashlyera të detyrimeve tatimore dhe vërtetim të sigurimeve shoqërore, të tre muajve të fundit nga data e aplikimit.
  - k) Vërtetim për numër llogarie bankare, në Lekë.
  - l) Deklaratë nga subjekti aplikues që nuk ka pranuar mjete nga burime të tjera financimi për të njëjtat aktivitete.
  - m) Informacion për kontributin dhe angazhimin e subjektit në fushën e medias dhe projektet e më përparshme që ka realizuar.
4. Mbi zarfin e aplikimit të shënohet “Rithirrje për aplikim projektsh II, viti 2026” si dhe të shkruhen të dhënat e thirrjes (datë, titull i projektit, etj).
5. Autoriteti i Mediave Audiovizive financon vetëm zërat referencë në listën e publikuar si pjesë e kësaj thirrje. Zërat që nuk janë pjesë e kësaj liste, duhet të mbulohen nga vetë aplikuesi.

## KËRKESA TË TJERA PËR APLIKUESIT

1. Subjektet që mund të paraqesin kërkesa për projekt-propozime pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, duhet:
  - a. Të jenë institucione dhe organizata joqeveritare;
  - b. Të jenë persona juridikë publikë;
2. Nuk mund të paraqesin projekt-propozime partitë politike, sindikatat apo organizatat politike.
3. Autoriteti i Mediave Audiovizive, nuk mbështet projekt-propozime që kanë lidhje pronësie direkt apo indirekt me OSHMA-të.
4. Subjektet të cilat kanë projekte në proces të mbështetur nga AMA, nuk kanë të drejtë të aplikojnë përpara përfundimit dhe paraqitjes së raportit final të këtij projekti.

Aplikimet e dorëzuara në protokollin e AMA-s, përtej datës dhe orës së përcaktuar si afat përfundimtar në këtë thirrje **data 17.07.2026, ora 12:00**, nuk do të merren në shqyrtim. AMA do të vijojë komunikimin dhe procedimin e mëtejshëm vetëm me subjektet aplikues, të cilëve iu vlerësohet aplikimi në përputhje me kërkesat e kësaj thirrje.

Në faqen zyrtare të AMA-s, gjeni rregulloren e brendshme “Mbi kriteret dhe procedurat për shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e projekteve”, në fushën e mediave audiovizive. (<https://ama.gov.al/wpcontent/uploads/2020/07/Vendim-nr.113-date-11.12.2023-P%C3%ABr-Miratimin-e-Rregullores-MbiKriteret-dhe-Procedurat-P%C3%ABr-Shqyrtimin-Miratimin-dhe-Zbatimin-e-Projekteve-t%C3%AB-AMAs.pdf>)

**Autoriteti i Mediave Audiovizive**

**Tiranë më, 08.06.2026**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME  
NË FUSHËN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE  
FORMULAR PËR APLIKIM PËR FONDE MBËSHËTETJE

**PJESA I: INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME**

Titulli i projektit: [.....]

Aplikanti (emri i organizatës që aplikon/partneri I): [.....]

Statusi ligjor i organizatës që aplikon:

Numri i regjistrimit të organizatës që aplikon: [.....]

Vendi i regjistrimit të organizatës që aplikon: [.....]

Data e regjistrimit të organizatës që aplikon: [.....]

Adresa: [.....]

Faqja në internet: [.....]

Personi i kontaktit: [.....]

Pozita në organizatë: [.....]

Tel: [.....]

E-mail: [.....]

Kohëzgjatja e projektit: nga data/muaj/vit [.....] deri në datën/muaj/vit [.....]

Vendi ose vendet e realizimit të projektit: [.....]

Fusha dhe tema e projektit: [.....]

Buxheti total: [.....]

Fondet e kërkuara nga AMA: [.....]

Informacion për bashkëfinancim (emri-shuma): [.....]

Partnerët e Projektit: [.....]

## **PJESA II: PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**

**Qëllimi i projektit:** Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti u përgjigjet nevojave të identifikuara (*maksimumi 10 rreshta*).

[.....]

**Objektivat e projektit** (*maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv*):

1. [.....]

2. [.....]

3. [.....]

4. [.....]

5. [.....]

**Lloji i aktiviteteve sipas fushës**, p.sh. studime tregu, rritje e zhvillim audiencash, aktivitete trajnuese, hulumtime..etj, si dhe një përshkrim më i detajuar i aktiviteteve që janë planifikuar në çdo fushë (*maksimumi 5 rreshta për secilin aktivitet*):

1. [.....]

2. [.....]

3. [.....]

4. [.....]

5. [.....]

**A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura?** (*Maksimumi 5 rreshta*):

[.....]

**A përmban projekti tregues objektivisht të verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve?** (*Maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet*):

Aktiviteti 1:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [.....]

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [.....]

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [.....]

Aktiviteti 4:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [.....]

Aktiviteti 5:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [.....]

**Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara?** (Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmbledhur, se cili është grupi parësor i synimit të projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e projektit.)

Maksimumi 5 rreshta: [.....]

**Qëndrueshmëria e projektit** – impakti afatgjatë i projektit nga pikëpamja e problematikës së adresuar, fushës së zhvillimit të projektit, si dhe organizatës që e propozon.

Maksimumi 5 rreshta: [.....]

**Në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e projektit, a është respektuar e drejta e autorit?** Maksimumi 5 rreshta: [.....]

### **PJESA III: PARTNERËT (NËSE KA)**

Bashkërendimi i punës midis partnerëve. (Përshkruani natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve duke përshkruar procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e projektit.)

Maksimumi 5 rreshta: [.....]

#### **Partneri 1 (Aplikanti)**

Misioni. Cili është misioni i organizatës tuaj?

Maksimumi 5 rreshta: [.....]

**Struktura.** Përshkruani strukturën e organizatës duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

Maksimumi 5 rreshta: [.....]

**Financimi.** Si financohet organizata juaj dhe cili ishte buxheti i saj për vitin paraardhës?

Maksimumi 5 rreshta: [.....]

#### **Partneri 2**

Emri organizatës: [.....]

Personi i kontaktit: [.....]

E-mail: [.....]

Adresa: [.....]

Faqja në internet: [.....]

#### **Partneri 3**

Emri i individit/organizatës: [.....]

Personi i kontaktit: [.....]

E-mail: [.....]

Adresa: [.....]

Faqja në internet: [.....]

#### **PJESA IV: BUXHETI**

Lutemi të përshkruani shpenzimet e përfshira për implementimin e projektit. Çfarë burimesh të fondeve të tjera janë të siguruar dhe të mundshme?

*Plotëso: Tabelën për kostot financiare pjesë e kësaj Thirrje*

## TABELA E KOSTOVE FINANCIARE

Emri i subjektit aplikues:

Titulli i Projektit:

Koha e zbatimit: nga/deri

Nr.	Lloji i shpenzimit	Njësia	Sasia	Çmimi në lekë	TOTAL	AMA	Vetë aplikanti	Donatorët e tjerë -I-	Donatorët e tjerë -II-
<b>SHPENZIMET SIPAS AKTIVITETEVE DHE ZËRAVE PËRKATËS</b>									
<b>1</b>	<b>AKTIVITETI 1: Titulli...</b>								
1.1									
1.2									
1.3									
	<b>TOTAL AKTIVITET _ 1</b>			-	-				
<b>2</b>	<b>AKTIVITETI 2: Titulli....</b>								
2.1									
2.2									
2.3									
	<b>TOTAL AKTIVITET _ 2</b>			-	-				
<b>3</b>	<b>AKTIVITETI 3: Titulli....</b>								
3.1									
3.2									
3.3									
	<b>TOTAL AKTIVITET _ 3</b>			-	-				

<b>4</b>	<b>AKTIVITETI 4: Titulli ...</b>								
4.1									
4.2									
4.3									
	<b>TOTAL AKTIVITET _ 4</b>			-	-				
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE (1+2+3+4+..) lekë</b>								
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE (1+2+3+4+..) %</b>								

**Sqarim:**

- Ju lutemi, të llogaritni shumën totale që mbulon çdo donator (duke përfshirë AMA-n dhe vetë subjektin aplikues), edhe si % e buxhetit total për projektin.



## Lista me zërat referencë që financohen nga AMA

	Zërat		
Nr.	I	Njësia	
	<i>Menaxhimi i projektit</i>		
1	Drejtuues projekti	Ditë/Muaj	
2	Jurist projekti	Ditë/Muaj	
3	Asistent projekti	Ditë/Muaj	
4	Kordinator	Ditë/Muaj	
5	Moderator në fokus grupe	Aktivitet	
6	Moderator për tryezë konsultuese	Aktivitet	
7	Folës për prezantim studimi	Aktivitet	
8	Moderator konference	Aktivitet	
	II		
	Ekspertët		
1	Ekspert dizanjues	Faqe	
2	Ekspert për mbledhje të dhënash	Ditë/Muaj	
3	Ekspert për analizim të dhënash	Ditë/Muaj	
4	Ekspert statistike	Ditë/Muaj	
5	Ekspert për metodologjinë	Ditë/Muaj	
6	Ekspert i ftuar	Aktivitet	
7	Ekspert për shkrim raporti	Faqe	
8	Ekspert për ngritjen e treguesve	Faqe	
9	Ekspert monitorues	Ditë/Muaj	
10	Ekspert për dizenjimin e instrumenteve	Ditë/Muaj	
11	Ekspert financiar	Ditë/Muaj	
12	Ekspert i medias	Ditë/Muaj	
13	Ekspert trajnues	Ditë/Muaj	
14	Ekspert të specialiteve të ndryshme	Ditë/Muaj	
	III		
	<i>Studim, përkthim, trajnime</i>		
1	Redaktim libri	Faqe	
2	E drejta e autorit	Vepër	
3	Faqosje	Faqe	
4	Printim	Faqe	
5	Studiues	Ditë/Muaj	
6	Shtypshkrim	Faqe	
7	Redaktim studimi	Faqe	
8	Redaktim raporti	Faqe	
9	Pagesë për të intervistuarit	Person	
10	Anketues	Person	
11	Intervistues	Person	

12	Hartues pyetësori	Copë	
13	Përkthyes	Faqe	
14	Trajnues	Ditë/Muaj	
15	Lektor	Leksion	
16	Konsulent i jashtëm	Ditë/Muaj	
17	Materiale trajnimi	Person	
18	Realizues sondazhi në terren	Person	
	<b>IV</b>		
	<i>Salla për konferencë, prezantim, trajnim</i>		
1	Sistem fonie konference	Aktivitet	
2	Qira salle për trajnim/ Tiranë	Aktivitet	
3	Qira salle për prezantim/ Tiranë	Aktivitet	
4	Qira salle për organizim konference/ Tiranë	Aktivitet	
5	Qira salle për trajnim/ Rrethe	Aktivitet	
6	Qira salle për organizim konference/ Rrethe	Aktivitet	
7	Qira salle për prezantim/ Rrethe	Aktivitet	
	<b>V</b>		
	<i>Shpenzime operative</i>		
1	Dieta	Ditë	
2	Transport	Km	